



Imagination
Ideas Inspiration
Innovation
Negotiation
Networking
Novelties
Necessities
Coordination
Concepts
Competences



Nr. 33

Viti i katërt i botimit

Shkurt 2016

Në këtë numër do të gjeni:

- 1 Vit rrugëtim shpresëplotë për të ardhmen (nga Nihat Dragoti)
- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Vazhdojnë punimet për instalimin e infrastrukturës turistike në PKD Karaburun-Sazan
- Njoftime

1 Vit rrugëtim shpresëplotë për të ardhmen!

Nga Nihat DRAGOTI

Ruajtja e Natyrës, Biodiversitetit dhe Zonat e Mbrojtura janë një nga trashëgimitë më të mëdha për jetesën e sotme, por që mund të lëmë edhe për brezat e ardhshëm. Zonat e mbrojtura në vendin tonë evidentohen në forma dhe madhësi të larmishme (tokësore, ujore dhe detare, lokale dhe ndërkufitare), në pronësi publike, bashkiake e private, me vlera kombëtare

e ndërkombëtare, pra një kompleksitet dhe trashëgimi që nuk është identifikuar dhe pasqyruar qartasi në politikat qeveritare dhe lokale.

Fatkeqësisht, për kujdesin dhe menaxhimin e tyre, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe standarteve ndërkombëtare, faktet flasin ndryshe. Gjendja dhe vëmendja ndaj tyre nuk ka qënë në nivelin e kërkuar. Ndërgjegjësimi, sjellja

Vijon në faqe 2



Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta © Foto INCA

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



Vijon nga faqe 1 qytetare dhe veprimet konkrete thuajse kanë munguar tërësisht.

pranishëm të keq menaxhimit më të mundshëm, e thënë ndryshe, në përbërje të tyre nuk kishte



PKD Karaburun-Sazan © Foto INCA

Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura ekzistojnë në një mjedis që ndryshon me shpejtësi në vendin tonë. Kërcënimet janë reale, pasqyruar me ndotjen e mjedisit; dëmtime të tipeve të habitateve e llojeve; përndjekja e vazhdueshme e llojeve të faunës së egër; fragmentim të peizazheve natyrore, tjetërsimi deri në zhdukje i formave të veçanta dhe unike gjeo-morfologjike; dukuritë e gërryerjes së tokës dhe të vijës bregdetare; prerja e diegja e pyjeve dhe e kullotave; gjuetia, mbikullotja dhe mbipeshkimi; rritja e pakontrolluar e infrastrukturës urbanizimit, zëniet dhe ndërtimet pakriter; ndërtimi i moleve dhe pistat në bregdet; guroret dhe minierat; ndërtimi i HEC-ve dhe shfrytëzimi i pamëshirshëm i lumenjëve, përfshi degët e tyre; turizmi i papërgjegjshëm; shtimi i nevojës për burime natyrore; lakmitë jo miqësore të bizneseve etj. Këto pak dukuri të përmendura janë problem kombëtar dhe jo vetëm i një institucioni, siç është vepruara deri më sot.

Strukturat për administrimin e menaxhimit e burimeve natyrore dhe të rrjetit të zonave të mbrojtura, kanë qënë jo të mirë organizuara, konfuzë, të orientuara nga interesa të ngushta e me ngjyrimë të theksuara, me rezultate të

profesionist, mbështetje politike e financiare.

Rrjeti përfaqësues i zonave të mbrojtura kërkonte një autoritet funksional për menaxhimin dhe administrimin e zonave të mbrojtura. Së bashku me përpjekjet për zgjerimin e sipërfaqes së tyre, pak është paraparë e nevojshme që të merren masa për të ngritur dhe forcuar kapacitetet e strukturave menaxhuese përkatëse.

Ishin këto arsye që shërbyen si nxitje për krijimin e AKZM. Një Agjenci që duhet t'i përkushtohet tërësisht mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit dhe menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura. Agjencia e sapo krijuar, ka detyrë funksionale të menaxhojë edhe rrjetet e tjera natyrore si Natura 2000, të monitorojë dhe inventarizojë habitatet, florën dhe faunën, peizazhin, etj. Aspekt i rëndësishëm është të gjenerojë të ardhura nga shërbimet ndaj të tjerëve dhe t'i përdorë për t'i investuar në zonat e mbrojtura.

Roli, kompetencat dhe juridiksioni i AKZM, janë konceptuar dhe ngritur sipas modelit të ideuar për kthimin e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura në identitet, në vendin që i takon, në standartet e përparuara të zonave të mbrojtura rajonale dhe më gjerë.

Krijimi dhe veprimtaria e AKZM është një faktor

Vijon nga faqe 2 i rëndësishëm pozitiv, në procesin e vështirë për thyerjen e koncepteve të ngushta të krijimit, menaxhimit dhe mirëpërdorimit të Rrjetit të ZM të vendit, nga shoqëria shqiptare dhe për t'u orientuar drejt ndërtimit të standarteve ndërkombëtare dhe evropiane të ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe peizazhit. Për nga karakteri dhe rëndësia e tyre, brenda kësaj periudhe relativisht të shkurtër të ekzistencës së AKZM, janë pikërisht dëshmi e këtij orientimi edhe zhvillimi i programit strategjikë afatshkurtër dhe afatmesëm, i prezantuar dhe veprimtaritë e shumta të ndëmarra nga AKZM. Gjatë kësaj periudhe janë pasqyruar nga mjaft media, të shkruar dhe vizive, si dhe jemi dëshmitar të këtyre veprimtarive të organizuara, veçanërisht nga personeli i AdRZM-ve: Divjakë-Karavasta, Karaburun-Sazan, Shebenik-Jabllanicë, Prespa, Thethi, Valbona, Liqeni i Shkodrës, Lumi i Bunës-Velipojë, Kune-Vain-Tale, Mali i Tomorrit, etj.

shpërndarjen e informacionit, edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin e publikut për zonat e mbrojtura.

AKZM nxit dhe përkrah zhvillimin e veprimtarive të qëndrueshme ekonomike, sociale dhe ekoturistike, brenda zonave të mbrojtura. Krijimi dhe funksionimi i administratave rajonale për zonat e mbrojtura, gjithashtu, sjellë lehtësi për mjaft projekte në kuadër edhe të programeve ndërkufitare.

AKZM-ja, ende “njomcake”, po tregon se nëpërmjet këtyre iniciativave dhe veprimeve konkrete siguron suksesin e menaxhimit të intreguar të zonave të mbrojtura, duke nxitur vendimmarrjen dhe vetë nxitjen e stafit të administratave. Preokupimi, për të siguruar të ardhura në rritje dhe për të investuar në mënyrë që të arrihet mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i elementeve të biodiversitetit, përbën një vlerë të shtuar për këtë institucion të ri.



Parku Kombëtar Theth © Foto INCA

Ngritja e kësaj Agjencie sjellë një zbatim më të mirë të legjislacionit vendas, në menaxhimin e rrjetit të zonave të mbrojtura, habitateve dhe llojeve natyrore e gjysmë natyrore me interes të ruajtjes, sipas ligjeve kombëtare, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Po kështu, promovon dhe mbështet grumbullimin dhe

Mendoj se AKZM-ja po prodhon dhe zbaton mendësi dhe risi të reja, nëpërmjet rikonceptimit dhe konsolidimit të menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipërisë, me personel të aftë e profesionistësh, me mbështetje dhe pjesëmarrjen e të gjithë palëve të interesuara. Mbi të gjitha AKZM ka bërë moto të punës së saj

Vijon nga faqe 3 përfshirjen e veçanët të komunitetit, pranë zonave të mbrojtura dhe të përdoruesve të tjerë, në ruajtjen dhe përdorimin e mençur të burimeve natyrore.

Si në çdo fushë që lëvrohet për herë të parë, edhe veprimtaria e AKZM është shoqëruar me vështirësi dhe kërkohet kohë që ajo të kalojë etapat e rritjes dhe të konsolidimit të saj, si institucion i mirëfilltë i ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe rritjes së “personalitetit” të Rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, brenda vendit, në rajon dhe më gjerë.

Gjatë rrugës 1 vjeçare të veprimtarisë, në sajë të

pronarët dhe individët të lidhur me interesat që ata kanë për përdorimin e baraspeshuar të burimeve natyrore në përgjithësi të vendit dhe në veçanti të atyre që përfshihen dhe janë pjesa më e rëndësishme e RrZM. Konsolidimi i menaxhimit kërkon edhe marrjen e përgjegjësive dhe kontributin e drejtpërdrejtë nga gjithë secili për menaxhimin e biodiversitetit, rrjetin e zonave të mbrojtura dhe peizazhin.

Me fillimet e veprimtarisë së saj AKZM është përpjekur jo vetëm të afirmojë programin e saj ambicioz, por edhe t'a përdorë atë realisht në terren ku ajo ushtron veprimtarinë e saj,



Peisazhi i Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë © Foto INCA

përpjekjeve të të gjithë drejtuesëve dhe stafit administrativ-monitorues, të vullnetit të mirë të qeverisë për të mbështetur veprimtarinë e këtij institucioni, AKZM ka mundur të hedhi hapin e parë dhe të krijojë fizionominë e saj, të sigurojë integritetin e një institucioni përgjegjës për të cilin është krijuar dhe të japë kontributin për konsolidimin e menaxhimit të RrZM.

Arritje janë bashkëpunimi dhe përpjekjet e përbashkëta me institucionet e tjera të shtetit shqiptar, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet kërkimore-shekncore dhe edukative, shoqërinë civile, etj. E një rëndësie të veçantë, e cila ka munguar më parë, është forcimi dhe rritja e bashkëveprimit me komunitetin e biznesit,

veçanërisht prej Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Mendoj se AKZM po punon fort për të krijuar dhe lënë pas një histori të larmishme të krijimit dhe menaxhimit të RrZM, duke filluar me tërheqjen e vëmendjes së politikës, qeverisë, institucioneve të tjera në nivel qendror e lokal, të shoqërisë civile, OJF-ve, aktorëve të interesuar dhe të donatorëve. Me autoritetin e saj, me veprime konkrete, AKZM dhe stafi po ndikojnë në përcaktimin e mënyrës sesi politika dhe të gjithë aktorët e tjerë duhet të sillen në raport me ruajtjen e natyrës, biodiversitetin dhe peizazhin.

AKZM është e ndërgjegjshme për përgjegjësinë që ka, andaj çdo punonjës dhe stafi në tërësi, në

Vijon nga faqe 4 rradhë të parë, duhet të mendojnë si qytetar e pastaj në funksionin që ata ushtrojnë. Në të njëjtën kohë është përpjekur që të jetë shumë e vëmendshme, që besimi i publikut ndaj veprimtarisë së saj të vijë në rritje, duke bërë kujdesin maksimal, që kontrolli, mbikqyrja dhe menaxhimi zonave të mbrojtura të mos shmanget nga synimet e caktuara dhe për ushtrimin e pavarur të veprimtarisë brenda kompetencave ligjore.

Në këtë 1 vit ka pasur arritje jo vetëm në aspektin teknik, por dhe në përpjekje të vazhdueshme për të përcaktuar qartë statusin në raport me organet e tjera dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj. Krahas programit strategjik, AKZM ka filluar punën për hartimin e ligjit të ri për zonat e mbrojtura dhe të paketës ligjore, një ndër hapat dhe arritje e

këtij institucioni. Ky qëndrim i ri i AKZM po shoqërohet me një angazhim më serioz të AdRZM, kryesisht në vendosjen e kontrollit mbi territorin, ekzekutimin e dispozitave ligjore, kryerjen e veprimeve gjithë përfshirëse e dobi prurëse për komunitetin, me vendosmëri e kompetencë, duke rritur e forcuar bashkëkomunikimin dhe bashkëveprimin e ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, shoqërinë civile dhe me të gjithë aktorët e interesuar.

Është një rast shumë i mirë për të gjithë stafin e AKZM që të bëhet një bilanc i punës me rastin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme, të 1 vjetorit të lindjes së AKZM.

Në emër të stafit të Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), Ju uroj: Paçi fat dhe suksese në rugëtimin tuaj!

... me këtë rast Ju kujtojmë se 56 vjet më parë ...

...ekonomia pyjore e Dajtit, në rrethin e Tiranës, me sipërfaqe 3,028.7 ha u shpall "Park Kombëtar", me vendim të Këshillit të Ministrave nr.93, datë 16.02.1960. Njëherazi përfaqëson edhe Parkun e parë Kombëtar të Shqipërisë.

Në kuadër të studimit për krijimin e Rrjetit të Parqeve Kombëtar të Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.96, datë 21.11.1966, sipërfaqja e PK Dajtit u zgjeruar me 3,300.0 ha.

Më pas, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.8906, datë 06.06.2002, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, ekosistemi natyrori Mali i Dajtit", me sipërfaqe 29,384.18 ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, me VKM nr.402, datë 21.06.2006, u rishpall "Park Kombëtar" me sipërfaqe të zgjeruar.

Më pas me VKM nr. 715, datë 23.06.2009, bazuar në studimin e kryer se në këto territore gjenden edhe komponente mineralogjike të tokave

të rralla si Vanadium, Galium, Germanium, Selen, etj, sipërfaqja e parkut kombëtar u zvogëluanë 29,216.89 ha. Brenda kësaj sipërfaqe u përfshi dhe Rezervati Natyror i Menaxhuar (ish rezervati i gjuetisë) "Qafë Mollë-Derje" me sipërfaqe 3,458.0ha, miratuar me rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë nr.1, datë 27.07.1977. Me urdherin nr.404, datë 25.01.1983 "Mbi caktimin e rezervateve të gjuetisë", sipërfaqja u ul në 3,300 ha. Ish Drejtorja e Përgjithshme e Pyjeve dhe Shërbimit Pyjor, me rastin e shpalljes së të parit Park Kombëtar në Shqipëri (Mali i Dajtit, më 16 Shkurt 1960), vendosi dhe festoi disa herë që dita 16 Shkurt, për çdo vit të jetë "DITA E PARQEVË KOMBËTAR TË SHQIPËRISË, por kjo iniciativë u ndërpre pas vitit 2006.

AKZM dhe Shoqata e Parqeve Kombëtare duhet ta riaktivizojnë dhe të organizojnë këtë vit një takim ripromovues në PK "Mali i Dajtit"...

...17 vjet më parë ...

...territori natyror i zonës së Prespës së Madhe dhe i Prespës së Vogël, me sipërfaqe të përgjithshme 27,750.0 ha, me VKM nr.80, datë 18.02.1999, shpallet "Park Kombëtar", përfshihet në qarkun e Korçës dhe në rrethet Korçë dhe Devoll. Brenda këtij territori është përfshirë (duke ndërruar dhe statusin) edhe sipërfaqja e ish rezervatit të gjuetisë "Gorricë", me sipërfaqe 18,150.0 ha, miratur me urdhër të ish Ministrisë së Bujqësisë, në vitin 1957.

Pjesë e territorit të Parkut Kombëtar "Prespa", gëzon edhe statusin e Zonës RAMSAR, sipas VKM nr.489, datë 13.06.2013, me sipërfaqe 15,118.6 ha.

- Me VKM nr. 80, datë 18.02.1999, territori natyror i pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit, me sipërfaqe të përgjithshme 27,323.0 ha, shpallet Peizazh i Mbrojtur tokësor/ujor", përfshihet në qarkun e Korçës dhe rrethin e Pogradecit...

...3 vjet më parë ...

...VKM nr. 221, datë 20.02.2013 "Për caktimin e zonave të brezit të gjelbër të qytetit të Tiranës dhe të rrethinave të tij", në mbështetje të neneve 3, 20/3 dhe 23 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2001 "Për mbrojtjen mjedisit", të ndryshuar dhe pikës 4, të nenit 27 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 "Përplanifikimin e territorit", të ndryshuar....

...11 vjet më parë ...

...me VKM nr.86, datë 11.02.2005 për "Krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura", në zbatim të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr.8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar....

...3 vjet më parë ...

...VKM nr.134, datë 20.02.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.693, datë 10.11.2005, të Keshillit të Ministrave, "Për shpalljen e kompleksit ligatinior të Butrintit "Park Kombëtar".

Me këtë VKM janë saktësuar kufijtë e parkut kombëtar të Butrintit, sipërfaqet e përdorimit të territorit...; ndryshohet pika 4 në lidhje me zonimin e territorit dhe pika 6 ndryshohet si më poshtë: Ngarkohen zyra e administrimit dhe koordinimit të PK të Butrintit, në varësi të MTKRS, administrata e PK, në varësi të MMPAU dhe Komiteti i Menaxhimit të këtij parku, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë menaxhimin e parkut dhe të kontrollojnë zbatimin e planit të menaxhimit të PK.

Shtohet pika 5.1, kundër të tjera theksohet që MMPAU, MTKRS dhe ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore të rishikojnë lejet që kanë dhënë për veprimtari ekonomike e shoqërore brendasi përfaqes së PK Butrint.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), me strukturat e vartësisë, ka detyrë dhe duhet të drejtojnë vëmendjen dhe të jetë më e kujdesshme në evidentimin dhe marrjen e masave për njohjen, ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e këtyre pasurive me vlerë të lënë në harresë dhe shumë pak të njohur për vendin tonë.

Vazhdojnë punimet për instalimin e infrastructures turistike në PKD Karaburun-Sazan

PKD Karaburun-Sazan, Janar 2016 - Në kuadër të iniciativës së Granteve të Vogla, realizuar me



mbeshtetjen e WWF, UNDP dhe CEPF, INCA po vazhdon punimet për instalimin e infrastrukturës ndihmëse turistike në Zonën e Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan.

Investimi i Granteve të Vogla konsiston në riparimin e molit të vjetër ushtarak në Gjirin e Shën Vasilit duke e bërë një mol të sigurt për ankorimin e varkave turistike gjatë sezonit të verës; instalimin e dy shtigjeve tokësore në Gadishullin e Karaburunit; instalimin e një shtegu nënurojor për zhytje me maska pranë gjirit të Shën Vasilit; kufizimin e Parkut Detar me sistem bovash pluskuese; instalimin e moleve të lëvizëshme në plazhe tërheqëse përgjatë pjesës lindore dhe perëndimore të gadishullit të Karaburunit dhe vendosjen e tabelave me informacion turistik në qytetin e Vlorës dhe në Njësine Administrative Orikum.

Deri me tani kanë përfunduar punimet në molin e Shën Vasilit dhe kanë nisur punimet për instalimin e shtigjeve tokësore.

NJOFTIME

2 Shkurt - Dita e Botërore e Ligatinave

4 Shkurt - Dita e themelimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM)

- 1 - Raporti i plotë studimor rreth vleresimit të cilësisë së studimeve të vleresimit të ndikimit në mjedis të projekteve të hidrocentraleve në Evropën Juglindore
http://d2ouvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/hidro_v6_webr.pdf
- 2 - Rrugëtimi drejt Parisit 2015 - për integrimin e çështjeve të NK në politikat dhe dokumentet strategjike të vendit.
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=item&id=438:rrugetimi-drejt-parisit-2015&Itemid=133&lang=sq
- 3 - Për të lexuar “*Ditari i Natyrës*” në vite...
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania